

## Procesverbal

*Nga Mbledhja VI (e gjashtë) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Dragashit, e mbajtur më datë:  
30.06.2025*

### *Rend Dite*

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028;
3. Miratimi i Listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në territorin e Komunës së Dragashit; dhe
4. Eventuale.

**Arijeta Skeraj:** Përshëndetje kryetar, kolegë asambleistë, shefe e OSBE-së e cila sot gjendet këtu, mdeia dhe të gjithë të pranishëm! Mirë se keni ardhë në seancën e gjashtë të rregullt për vitin 2025! Materialin besoj që e keni pranuar të gjithë, bashkë me pikat e rendit të ditës! A do dikush me e marrë fjalën rreth rendit të ditës?

**Shpetim Hajredini:** Përshëndetje, i nderuar ekzekutiv! Të nderuar kolegë/e asambleistë/e, shefe e OSBE-së, media, qytetarë të nderuar të Dragashit! Për rendin e ditës, jo, nuk e mora fjalën. Po e shoh që nuk e kemi median kryesore të transmetimit të mbledhjeve të Asamblesë Komunale, Radio Sharrin. Kisha pas dëshirë ta di, pse mungon Radio Sharrin këtu dhe çka ka ndodhë. Ai ka kontratë dhe ligjërisht duhet të jetë, ta bëjë transmetimin, që qytetarët t'i ndjekin drejtpërdrejt seancat të cilat i mbajmë ne këtu në Kuvend. Faleminderit!

**Nedžmidin Sejdilar:** I shqetësuar për mungesën e Radio Sharrit, ndaj shqetësimin bashkë me z. Haradinaj këtu. Mendoj se ai ka qenë i pranishëm për tri vite e më shumë, pothuajse katër vite. Tani papritmas nuk është më dhe pres të marr përgjigje për këtë çështje. Megjithatë, çështja tjetër që më shqetëson është rendi i ditës. Ne të premtën e kaluar kemi pasur Komitetin për Komunitete, dhe unë kam qenë i pranishëm, znj. Kryesuese, edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa. Po flas për rendin e ditës. Vetëm kalimthi iu referova Shpetimit. Ne të premtën kishim Komitetin për Komunitete dhe isha i pranishëm në Komitetin për Politikë dhe Financa. Vetë kryetari i Komunës tha që në draftin e Kornizës Afatmesme Buxhetore, sidomos për vendbanimet në Gorë, buxheti është i pasaktë sepse Excel-i ka gabuar. Këto ishin fjalët tuaja, z. Kryetar. Edhe në Komitetin për Komunitete, shefi i Zyrës për Komunitete e ka konfirmuar të

njëjtën gjë. Ku është ai? Nuk po e shoh. Ai gjithashtu e konfirmoi këtë. Znj. kryesuese, unë nuk kam marrë material të duhur. Kam marrë një draft të gabuar të buxhetit dhe nuk jam i përgatitur për të diskutuar për këtë. Z. Miralem Rahte, si kryesues i Komitetit për Komunitete, mori vendim në Komitet që materiali të na dorëzohet deri sot. Ende nuk e kam marrë atë material. Si të diskutoj për këtë tani? Prandaj, propozimi im është që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet, sepse unë nuk jam i përgatitur, nuk e di për çfarë të flas. Po shihni që po flas për rendin e ditës, dhe ju menjëherë më ndërprisni, për të krijuar konfuzion dhe për të më fajësuar mua. Qeshni, z. Cipiripi, në rregull është. Hajde, ngrihuni, ejani këtu, ju e keni marrë atë vendim, tregoni çfarë keni vendosur. Ku është materiali? Ju keni marrë vendim ta dërgoni materialin gjatë fundjavës, nuk e keni dërguar. A keni shtyllë kurrizore, more njeri? Apo e keni harruar në shtëpi? Prandaj, znj. kryesuese, kërkoj mirëkuptim nga ju, nga kryetari dhe nga të gjithë asambleistët këtu, sepse ne në Gorë kemi material të gabuar. Kemi informacione të pasakta në draftin e Kornizës Afatmesme Buxhetore dhe unë nuk mund të diskutoj për këtë. Në ndryshim nga shumë përfaqësues tanë këtu nga Gorë, unë e bëj punën time me përgjegjësi dhe nuk dua të bëj ndonjë gabim që do të dëmtojë qytetarët e mi. Prandaj ju lutem që kjo pikë të shtyhet. Dhe propozimi im është që të votohet që kjo pikë e rendit të ditës, për Kornizën Afatmesme Buxhetore, të shtyhet për ndonjë mbledhje tjetër, sepse nuk jam i përgatitur për të debatuar për këtë. Faleminderit!

**Munir Jonuzi:** Zonja kryesuese, i nderuar kryetar, kolegë të nderuar asambleistë, i nderuar përfaqësues i OSBE-së, të nderuar anëtarë të ekzekutivit, media të pranishme – përshëndetje! Unë po paraqitem lidhur me rendin e ditës, vetëm për të konfirmuar pohimet që i dha kolegu Nedžmidin këtu në foltoren e Kuvendit. Unë, si zëvendësues i kryesueses së Komitetit për Komunitete, kam marrë pjesë në Komitetin për Komunitete dhe në atë komitet ka pasur dy propozime. Një propozim ishte nga kolegu Nedžmidin, i cili kërkoi që kjo pikë të shtyhet dhe të shqyrtohet në një nga seancat e ardhshme. Propozimi i dytë ishte nga kryesuesi i Komitetit për Komunitete, z. Miralem, i cili propozoi që materiali për delegatët nga komuniteti jo-shumicë të dërgohet përmes e-mailit. Sepse kemi shumë gabime sa i përket versionit zyrtar të buxhetit që kemi marrë, dhe ky këtu është versioni që e kam marrë nga shefi i Zyrës për Komunitete. Këto gabime i ka konfirmuar edhe vetë kryetari – thjesht ka pasur keqkuptime me këshilltarin e lartë financiar, dhe buxheti për Gorë që e kemi marrë në material nuk është i saktë. Këtu shpreh keqardhjen që kryesuesi i Komitetit për Komunitete nuk e ka njoftuar Shërbimin e Kuvendit që

ta dërgojë materialin të gjithë delegatëve, nëse jo tjetër, së paku delegatëve nga komuniteti jo-shumicë, dhe versionin e ndryshuar. Prandaj, unë e përkrah plotësisht propozimin e z. Nedžmidin, i cili kërkon që të shtyhet, sepse ai dhe shumica e delegatëve nga komuniteti jo-shumicë nuk janë të përgatitur për ta shqyrtuar këtë buxhet. Ju faleminderit!

**Bexhet Xheladini:** E nderuar kryesuese, i nderuar zv/kryesues, të nderuar delegatë, të nderuara media, i nderuar përfaësues i OSBE-së! Në KPF, ne kemi debatuar për KAB-in, dhe aty nuk është dhënë propozimi që të shtyhet kjo pikë. Por, jemi marrë vesh që në mbledhjen e sotit, nëse ka nevojë, mund të propozohen ndryshime. Ato ndryshime secili prej delegatëve ka të drejtë t'i propozojë, edhe Asambleja Komunale t'i miratojë, kështu që këto të futen në dokumentin përfundimtar. Nuk do të ketë problem, për arsye se ky është një votim preliminar i KAB-it apo i buxhetit, në shtator merret vendimi definitiv. Ka gabime në emërtime, por sa i përket shumës së mjeteve nuk ka gabime. Andaj, u propozoj delegatëve që ta votojnë rendin e ditës dhe në pikën ku do të diskutohet për KAB-in, aty ku ka gabime ose ku ka nevojë me ndryshue, delegatët le të dalin në foltore, të japin propozimet dhe Asambleja le të votojë. Sa i përket Radio Sharrit, ju e dini që Seancën solemne e cila është mbajtur për nder të Ditës së Çlirimit, ku në atë seancë është bërë edhe binjakëzimi me Komunën e Mavrovës dhe Rostushës, Radio Sharrin, me qëllim apo pa qëllim, me porosi të dikujt ose pa porosi të dikujt, nuk e ka bërë transmetimin drejtpërdrejt. Çka është më e keqja, nuk e ka përgatitur materialin edhe ditën e nesërme. Kështu që, Seanca solemne, Dita e Çlirimit është ditë e veçantë, dhe nuk është ai film me e incizue edhe me mujt me e pa mas një apo dy muajve. Seanca duhet të transmetohet drejtpërdrejt. Kjo është hera e dytë ai që po e bën këtë gabim. Herën e parë e kemi thirrë, ia kemi tërheq vërejtjen edhe ai ka thënë që ky gabim nuk do të përsëritet. Megjithatë, ai e ka përsëritur edhe unë i kam dhënë vërejtje, i kam thënë përkohësisht do ta marrim një qëndrim që të pezullojmë raportet me Radio Sharrin, të ulemi, të bisedojmë dhe më të mos na përsëriten gjëra të tilla në të ardhmen. Faleminderit!

**Shpetim Hajredini:** Faleminderit, kryetar, për përgjigjen! Unë kam përgjigje krejt tjetër nga personi në fjalë i cili është edhe përgjegjës i Radio Sharrit. Por, ajo që ka ndodhë ndërmjet ekzekutivit edhe Radio Sharrit, për mostransmetimin e Ditës së Çlirimit, ajo duhet të mbetet mes jush. Kontrata valide qëndron ndërmjet Kuvendit Komunal të Dragashit dhe Radio Sharrit, dhe ajo duhet të vazhdojë edhe për këto seanca të cilat kanë mbetur. Pastaj, nëse jeni prapë, vazhdoni, ishalla, ju a na, kushdo që të jemi pas tetorit, atëherë vendosim nëse do ia zgjasim apo jo. Por, tash

Radio Sharri duhe të jetë pjesë e këtij Kuvendi Komunal dhe duhet ta bëjë transmetimin. Nuk po du të them se do të dalim nga seanca nëse nuk është prezent Radio Sharri, pasi po pres që ju ta ftoni edhe të jetë pjesë e kësaj seance, edhe të vazhdojë transmetimin. Nëse Radio Sharri nuk kthehet, ne nuk vazhdojmë me seancën. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Përshëndetje për ju të pranishëm! E mora fjalën në lidhje me mosprezencën e Radio Sharrit. Është akt i cili nuk i ndihmon demokracisë edhe transparencës, znj.kryesuese. Përderisa ne nuk e shohim një kontratë të shkëputur mes Radio Sharrit, unë besoj që Radio Sharri duhet me qenë këtu edhe me e transmetue seancën. Marrëdhëniet, qysh i keni ju me Radio Sharrin, ajo është çështje e juaja, z.kryetar. Mirëpo, nëse nuk është ai prezent, duhet me na paraqit një shkëputje të kontratës që na me vazhdue. Përndryshe, Radio Sharri duhe të jetë pjesë e transmetimit të seancave. Faleminderit!

**Arijeta Skeraj:** Atëherë, punën e Radio Sharrit do ta lëmë në eventuale, rendi i ditës është rendi i ditës. Besoj që prej kryetarit e keni marrë përgjigjen. Përndryshe, unë si kryesuese e Kuvendit dua të ju them të gjithë Asamblesë, mediave dhe të gjithë të pranishmëve, prej se jam bo unë kryesuese, asnjë seancë live nuk u paraqit. Ju duhet bile me e ngrit zërin, pse Radio Sharri që ka kontratë me Komunën e Dragashit, asnjë seancë live nuk e ka transmetue, qysh se jam bo unë kryesuese. Aq më keq, nuk e ka bo edhe seancën për Ditën e Çlirimit. Në qoftë se Asambleja e merrni një vendim të tillë, që të mos ju transmetohet drejtpërdrejt Dita e Çlirimit dhe binjakëzimi që u bo, atëherë edhe unë nuk po di edhe po më vjen keq që jam kryesuese, edhe merrni këso vendime personale ose edhe grupe.

**Munir Jonuzi:** Faleminderit. Derisa kryetari të mos bisedojë me njerëzit nga Radio Sharri, unë do të propozoja që dy operatorët tjerë – Televizioni Opoja dhe Radio Bambus – t’i transmetojnë këto incizime në gjuhët që i flasim. Po, nëse është e mundur, Televizioni Opoja të mos i përkthejë në postimet e veta, që edhe ne të kemi origjinalisht atë që e flasim. Sepse në përkthim humbet kuptimi i fjalisë sonë. Nëse është e mundur, Televizioni Opoja sot t’i transmetojë pa përkthim, por ashtu siç i themi ne – në mënyrë origjinale. Faleminderit.

**Samidin Xheladini:** Të nderuar të pranishëm, ju përshëndes të gjithëve! Po më vjen keq, ne delegatët me u marrë me çështje të mediave. Ligji e parasheh saktë, delegatët nuk bën me u marrë me çështje të mediave. Për arsye se, ligji e parasheh që seancat të jenë publike. Dhe, mediat janë të pavarura. Ato na nuk i ndalim kurrë, kërkon s’e ndalim, asnjë qytetarë. Kjo është seancë publike, ka të drejtë me marrë çdo qytetarë pjesë. Çdo media, çdo gazetar ka të drejtë me marrë

pjesë. Kontrata me këta është krejt diçka tjetër, në suaza të asaj që, si media lokale, ai e ka obligim, për hir të transparencës të punës që e bën, duhet me ardhë me e transmetue. Edhe, jo me e transmetue për ne, por me e transmetue për popullin, për informimin. Le të vijke ai këti, ka kontratë apo jo, duhet me e transmetue. Ka njerëz që nuk kanë kontratë fare edhe vijnë këtu. Qe për shembull të OSBE-së, çfarë kontratë kanë me ne? Vijnë na monitorojnë neve. Vijnë plot asociacione e njerëz tjerë na monitorojnë, vijnë këtu vullnetarisht. Ky nuk është arsyetim, edhe më erdh keq që kushtëzove, thaje ne nuk marrim pjesë. Ky kushtëzimi, për mu – nuk dashta me e thënë në publik, po tash po e them – këtu diçka nuk është në rregull me Radio Sharrin. Kam respekt, por nuk është në rregull me Radio Sharrin. Ai duhet me i ditë detyrat e veta. Edhe ju pse po e përkrahni, “nuk marrim pjesë në seancë”, nuk keni bo kontratë ju. Me popullin keni kontratë, nuk keni me Radio Sharrin. Faleminderit!

**Nexhat Selaj:** Përshëndetje kryesuese, kryetar, përshëndetje asambleistë, OSBE! Kryesuese, nuk po më pëlqen kur po thuesh edhe seancat nuk i ka paraqit live asnjëherë. Ku keni qenë deri tash, kur nuk kanë qenë ato live. Shumë mirë e dijs, edhe ju, edhe kryetari, edhe kolegët, sa herë e kemi qit këtë brengë, e kemi shpalos këtu para juve, se nuk është duke i dhënë live Radio Sharri seancat. Për këtë ju keni qenë të njoftuar. Sa i përket mosprezencës ose mosparaqitjes së seancës së fundit, Ditës së Çlirimit live, ato janë punë të juaja, nuk janë punë të neve, të Kuvendit. Ne jemi në opozitë, për ato duhet të merreni. Nuk po e ndaj mendimin, me thënë ka bo mirë. Mirë nuk ka bo, por kontratën e bën ekzekutivi me të. Dhe, ne kërkojmë një llogaridhënie edhe nga ju – se nga paret tona ndahet buxheti edhe paguhet Radio Sharri. Unë po mendoj që një pauzë prej 15 minutave, që me shefat e grupeve parlamentare, me ju dhe me kryetarin, ta bëni një konsultë pak më të gjerë, pasi që janë fundet e seancave të kësaj qeverisjeje. Ka plot me u debatue, mos të humbe kjo seancë! Për nja 15 minuta bëne një konsultë të vogël, se qytetarët presin. Pa Radio Sharrin, të cilën qytetarët mezi ka prej tyre që e presin këtë seancë ta dëgjojnë. Bashkatdhetarët, ne ishim në vizitë, pamë se sa ndiqet Radio Sharri nëpërmjet mjeteve të informimit live. Pse me dështue? Mu po më del një pyetje tjetër – a mos është nga ana juaj e qëllimtë, më fal që po them, se është fundi edhe ndoshta ka edhe plot për me u debatue këtu, e keni bo ju me qëllim, vetëm mos me u dhënë drejtpërdrejt. Nuk po due të jetë kështu, po po shtihet me dyshue, mos e keni bo me qëllime ju. Tash, unë për një konsultë 15 minuta, eventualisht 20 minuta, do t’ju jap të drejtë shefave të grupeve parlamentare, edhe juve me kryetarin. Bëjeni një zgjidhje që seanca të vazhdojë! Faleminderit!

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit! E lus Televizionin Opoja që të jetë live! A munden me ma konfirmue që është live? Atëherë më mbetet me dalë në foltore!

z.Nexhat Selaj m'u drejtua mua si kryesuese. Qysh kur jam betuar këtu si kryesuese, nuk është transmetuar nga Radio Sharrri. Atëherë, unë e kam bërë menjëherë një reagim te kryetari, i kam thënë, të lutem, merr masa që seancat të jenë gjithmonë live. Qe dy vjet që jam kryesuese, ju kisha lut, mundeni me hy në Radio Sharr, asnjë seancë nuk është bërë live. Atëherë, prapë i jam drejtue organeve, i jam drejtuar edhe zyrtarit ligjor, edhe kryetarit, edhe të gjithë ekzekutivit, se çka po ndodh me Radio Sharrin. Kjo nuk është veç kundër meje, por është edhe kundër juve, asambleistë. E kam thirrë Beqën – ne nuk jemi kundër mediave, absolut, bile edhe sot s'jam mediave – por një gjë kur të përbuzet dy vjet edhe vjen në kulm... unë prapë s'e kam marrë atë vendim, atë vendim e ka marrë ekzekutivi, e jo unë. Por, unë jam shkelë, bashkë me gjithë juve asambleistët. Bile ju nuk është mirë me e diskutue, ose me e lyp çka po ndodh me Radio Sharrin. Ju kisha lut të gjithë asambleistëve, hyni kqyrne Radio Sharrin, mos të them, që thirrjet që i bëj për seancë nuk i qet në kohën e duhur qysh ka kontratë. I kam lajmëruë kryetarit, çka po ndodh, ju keni kontratë, duhet mu me m'i qit thirrjet, duhet me ma qit seancën live. Beqir Beqaj ka ardhë në zyrë të kryetarit edhe më ka thënë unë sot s'kam mund me e qit. Në qoftë se një seancë nuk qitet live, që ka kontratë me Komunën e Dragashit, çka ka me pas nesër qytetari me e dëgjue atë. Mua po më vjen keq, seriozisht, që jam kryesuese dhe që disa asambleistë, por edhe ju të ishit në vendin tem, bile dy seancat e para nuk do ta kishit pranue. Edhe sot, nuk jam unë ajo që e kam ndalue Radio Sharrin, se unë nuk kam asnjë kontratë me të, unë thjesht veç seancën ia bëj, por organet tjera janë ato që sot ia kanë ndalue. Le të marrë vesh, se ka thënë dy herë, te kryetari më ka thënë kjo është hera e fundit. Kurrë nuk ke hera e fundit për Radio Sharrin. Është turp për Radio Sharrin që ka pas kontratë edhe nuk ma ka përcjellë asnjë seancë. More edhe seanca mos të përcillet, Dita e Çlirimit është për ne shumë e madhe. Në të gjitha komunat ditën e çlirimit krejt e kanë përcjellë live. Por prapë, po them, unë sot nuk e kam bo, e ka bo ekzekutivi. Faleminderit! Edhe tash, prej këtu, pasi është një propozim, unë, në qoftë se më lejohet me e marrë një vendim, unë i thirri shefat e grupeve në zyrën time, ta diskutojmë dhe ta qartësojmë. Përndryshe, unë së paku nja dhjetë herë i kam thënë kryetarit, po më neglizhon, po ma neglizhon seancën, se neve duhet me na pa populli çka po folim, çka po thojnë, çka po këkojnë. Lus të gjithë shefat e grupeve, bashkë me kryetarin, që në zyrën time të ju pres. Faleminderit!

*(pas konsultimit)*

Atëherë, po e fillojmë mas kësaj pauze këtë seancë. Ne kemi transmetim live. Unë i pata të gjithë shefat e grupeve dhe iu tregova krejt çka ka ndodhë këto dy vite. Nuk është që e kam penguar unë Radio Sharrin, është ekzekutivi që e ka marrë një masë paralajmërimi, jo që ia ka shkëput kontratën. Ne vazhdojmë me rendin e ditës. A do dikush me e marrë fjalën rreth rendit të ditës?

**Artan Loshaj:** Përshëndetje për të gjithë! Kjo që po ndodh sot është shumë e pafalshme dhe e papranueshme, për arsye se, para disa muajve, kur kam reague unë – nuk jam kundër Tv Opojës – kur kam reague që Tv Opoja ka qenë direkt live, edhe për ato konfliktet mes vete, ju të pushtetit që e keni pas problemin, live-n e keni detyrue me e fshi Tv Opojën. Pas reagimit tim këtu, në këtë foltore, msas disa ditëve Tv Opoja e ka kthye llajvin që e ka fshi, e ka kthye në Tv Opojë, por disa incizime, ato sende më të sikletshme të juajat, i ka asi. Sot, krejt Komuna e Dragashit, gjithë ky Kuvend, mos me e pas një Radio Sharr që ka kontratë publike, atëherë Tv Opoja edhe ky tjetri nuk kanë kontrata edhe janë këtu prezent, e Radio Sharrin me e penalizue, tre-katër muaj para zgjedhjeve, kjo është e pafalshme edhe e papranueshme, edhe jemi kundër ne të PDK-së.

**Jetmir Ajdini:** Përshëndetje të gjithëve! Për vazhdimin e kësaj seance, ne i kërkuam kryetarit që media e cila ka kontratë me Kuvendin Komunal për transmetimin live të seancave, të jetë prezente. Tash për arsye që kryetari i di, nuk na ofroi dëshmi që ia ka shkëput kontratën, nuk na ofroi dëshmi edhe arsyet pse media publike e cila paguhet nga taksat tona nuk është prezente këtu, na detyron neve si grup parlamentar VV-së, që ta lëshojmë këtë seancë në mënyrë demonstrative, që të mos shkelen të drejtat e mediave, por të transmetohet live seanca edhe qytetarët të dinë çka folet në Kuvendin Komunal të Dragashit. Tash kryetari është aq kokëfortë, sa që nuk lejon që media të kthehet këtu, atëherë ne në mënyrë demonstrative, se ne mënyrë tjetër nuk kemi, në mënyrë demonstrative do ta lëshojmë seancën. Faleminderit!

**Uran Halimi:** E mbështs patjetër vendimin e shefit të Grupit Parlamentar, z.Ajdini. Siç edhe e tha z.Loshaj, këtu janë manipuluar vazhdimisht me videoincizimet e seancave, është ndërprerë transmetimi live kur juve ju ka konvenue. Qetash po ju konvenon që me e ndërpre transmetimin prapë, pa ndonjë shkëputje të kontratës, pa ndonjë vërejtje me shkrim – nuk ka dëshmi. Është kërkesë e jona që Radio Sharrin të kthehet në Kuvend, ose të paktën të vijë ai këtu, ta marrë fjalën edhe të na tregojë se çka ka ndodhë, cilat janë arsyet. Mundeni me thënë që s'na ka ngue kur na kemi kërkuar me hi live. Dy vjet kur unë jam konë kryesues, Radio Sharrin ka transmetue live pa e urdhëruar unë – bon vaki – shpeshherë. I kam thënë që duhet me e transmetue live, se po e kërkojnë qytetarët, edhe Radio Sharrin ka bo transmetimin e secilës seancë në mënyrë direkte. Atëherë nuk

e kemi pas na problem edhe për zënka, edhe për kurgjo tjetër. Mirëpo, sot, kur juve ju konvenon, ai s' duhet me e transmetue, edhe kur s'ju konvenon, duhet me u suspendue prej transmetimit. Unë kërkoj që Radio Sharri të ftohet për një fjalim këtu, të na tregojë çka është duke ndodhë edhe, kur ne dojmë me ia dhënë fjalën – se mundeni me thënë që ai s'ka të drejtë me folë po këtu kanë folë plot persona që s'kanë pas të drejtë me folë, kur ne jau kemi kërku me e marrë fjalën edhe kur ne jau kemi leju fjalimin. Është mirë me e thirrë Radio Sharrin, edhe me na tregue çka është t'u ndodhë, cila është arsyeja ai nuk është sot këtu. Ta shohim çka po ndodh! Faleminderit!

**Nedžmidin Sejdilar:** E ndaj mendimin me kolegët nga opozita – zotëri Halimi, zotëri Jetmir, si dhe zotëri Shpetim – lidhur me çështjen e mediumit Radio Sharri.

Në takimin që patëm pak më parë, ne shefat e grupeve parlamentare, u arrit në përfundim se sot ju e keni ndëshkuar Radio Sharrin me qëllim që ta disiplinoni. Sepse, sipas informatave që kam marrë, kontrata nuk i është anuluar, por i është ndaluar të vijë këtu. T'i ndalosh një mediumi që të vijë dhe të përcjellë punimet e Kuvendit është shkelje flagrante e të drejtave të njeriut – të drejtave të mediave. Çdo medium ka të drejtë të vijë këtu dhe të incizojë. Ndërsa ju nuk keni të drejtë t'ia ndaloni askujt këtë. Ju mund t'i ndërprisni kontratën, por nuk keni të drejtë t'ia ndaloni hyrjen. Prandaj, zonja dhe zotërinj, unë kërkoj – dhe ndaj mendimin me të gjithë delegatët këtu – që Radio Sharri të ftohet, t'i jepen dy minuta fjalë, që kjo çështje të mbyllet një herë e mirë. Ajo që dëgjova në takim më ka prekur me të vërtetë, sepse ju keni dëshmuar se mund t'ua ndaloni edhe mediave se kush mund të raportoje dhe kush jo. Kjo është ta mbash popullin në errësirë. Nëse ai transmeton drejtpërdrejt apo jo, le ta ndëshkojmë të gjithë, si Kuvend. Por sot, në mënyrë që të arrijmë te faktet, te përfundimet – për të ditur kush ka të drejtë, ai apo ju nga pushteti ekzekutiv – duhet ta kemi njeriun këtu që të na sqarojë çfarë ka ndodhur. Faleminderit.

**Arijeta Skeraj:** Unë sinqerisht nuk i kam thënë Radio Sharrit mos me ardhë. Pse me e thirrë, kur asnjë seancë mu nuk ma ka transmetue. Edhe me e thirrë, ai prapë s'ka me e transmetue. Unë nuk jam e obliguar me e thirrë Radio Sharrin. Dr. Jetmir, me mua nuk ka kontartë, ose tu nuk po kupton, ose unë nuk po kuptoj. Me Kuvendin Komunal nuk ka kontratë. Me ekzekutivin, ekzekutivi e ka parë të arsyeshme sot me ia pezullue. Unë nuk kam të bëj këtu. Ne nuk jemi kundër mediave, edhe këtë ta dini. A po vazhdojmë me diskutime rreth kësaj hala, apo po e vazhdojmë seancën, ose po e mbyllim? Në dorën tuaj është, vendosni! Kryetari i Komunës e ka fjalën për vendimin e fundit ndaj Radio Sharrit.

**Bexhet Xheladini:** Ne nuk e kemi marrë vendimin dje ose pardje. Ka gati ma shumë se dy javë, prej datës 13 qershor unë atij ia kam tërheq vërejtjen që ne do ta pezullojmë bashkëpunimin me Radio Sharrin, deri në një zgjidhje, kur ta gjejmë një kompromis me të. Arsyeja pse e kam bërë këtë është se ai nuk e ka transmetue në mënyrë të drejtpërdrejt Ditën e Çlirimit dhe ditën kur ne kemi nënshkruar marrëveshje të binjakëzimit me Komunën e Mavrovë-Rostushës. Ai e ka përsërit këtë disa herë, unë e kam thirrë në zyrë disa herë, ai gjithmonë më ka premtuar që do të përmirësohet, i ka dhënë do arsye personale, familjare, jo nuk po punon 4G-ja, jo andej, e jo këndeje. Kulminacioni ka qenë në Ditën e Çlirimit. Nëse ju nuk jeni për atë që nuk është me rëndësi Dita e Çlirimit me dëgjue këtu se çka është bo, por me e dëgjue pas dy-tri ditëve, bile nuk e di edhe mas dy-tri ditëve a e ka qit. Ditën e Çlirimit edhe ditën e nesërme nuk e ka qit. Pastaj, pasnesër ndoshta e ka qit. Kështu që, vendimi është që ai mos me marrë pjesë në një seancë, në mënyrë që ta shohë që nuk bën ai me luajt me Komunën edhe me seancat e Asamblesë. Ne as nuk ia kemi pezulluar, e as ndërprerë kontratën. Unë nuk jam për me ia ndërpre. Por, nëse ai vazhdon, do t'i ndjekim procedurat edhe e ndërpresim. E shpallim një thirrje publike edhe konkurrojnë kompanitë, mediat të cilat i plotësojnë kushtet. Kështu që, sot Radio Sharri nuk do të marrë pjesë në këtë seancë!

**Arijeta Skeraj:** Atëherë, i lus shefat e grupeve për nga një prononcim. Kryetarin e morët vesh.

**Shpetim Hajredini:** U zgjat shumë edhe ky diskutimi i cili, besoj që nuk ka qenë bile shumë e arsyeshme, por po na detyroni, shumë seanca na keni prurë në një pikë ku është dashtë patjetër të merren vendime të cilat ndoshta janë edhe jo të mira për qytetarët. Por, patjetër që ne jemi këtu për të mirën e tyre, edhe ata nëse nuk na shohin e nuk na dëgjojnë neve, nuk e dinë edhe çka po ndodh këtu. Prandaj, unë e kam dhënë vendimin tim në fjalimin paraparak që e pata, edhe gjatë diskutimit që e patëm ne nuk morëm ndonjë vendim, sepse ju nuk po lëshoni pe. Gjithmonë jeni mësue na me u tërheq, a ju me i shkue deri në fund – po atë gjo e kam bo gjithmonë vetëm për hir të qytetarëve – jam tërheq gjithmonë, edhe pse e kam marrë një vendim, pastaj jam tërheq, për të mirën të mirën e tyre. Mirëpo. Sot e thashe dhe në takim që nuk tërhiqem, edhe Radio Sharri duhet të jetë prezent, ligjërisht i lejohet atij me qenë prezent, edhe nëse ju e keni lajmëruar, e keni pezulluar, çkado që keni marrë vendim me gojë, gojarisht, për mu ato nuk qëndrojnë edhe ai duhet të jetë këtu prezent. Nuk ka njeri në rruzullin tokësor që që munden me ia ndaluar atij prezencën, që ta kryejë transmetimin live të seancave të cilat i mbajmë ne këtu në Kuvend. Prandaj, vendimi i kryetarit ka të bëjë me transmetimet jashtë kësaj sale. Çka ka të bëjë me këtë sallë, kryetari s'ka të bëjë asgjë me ne dhe nuk mund me marrë vendim. Vendimin e merr kryesuesja, por pasi që

kontrata është ndërmjet ekzekutivit dhe Radio Sharrit, ky e ka të drejtën legjitime që t'ia ndërpresë. Por është dashtë t'ia ndërpresë, jo qysh po thotë ai, s'e di çka ka bo me gojë, si e ka pezullue, po prapë pjesëmarrjen nuk ka të drejtë me ia ndalue. Ai duhet të jetë prezent këtu, nuk është dashtë t'ia ndalojë, është dashtë t'i thotë që ti je i pezulluar në aktivitetet tjera jashtë këtij objekti këtu ku jemi ne sot. Brenda këtij objekti nuk ka të drejtë t'i ndalohet. Prandaj, përfundimisht, unë nuk vazhdoj seancën nëse Radio Sharrin, së paku, po e potencoj edhe një herë, nuk vjen këtu në këtë foltore dhe nuk jep shpjegim se çfarë ka ndodhur se cili është realiteti.

**Samidin Xheladini:** Të nderuar të pranishëm delegatë! Ne jemi vetë dëshmitarë – unë sot po marr vesh çka ka ndodhë. Ju e paskit dëgjë, pikërisht parafolësit, s'po them 100%, por parafolësit e kanë akuzue. E keni akuzue Radio Sharrin se s'po e bën qeto, s'po e transmeton qeto. Kqyre, ne jemi organi më i lartë i Komunës, mos e qitni veten në nivel të poshtë. Organi më i lartë i Komunës është Kuvendi. Vetë ju, qeta sot që po folni ndryshe, që po e mbroni, keni bo një mori akuzash për Radio Sharrin, unë asnjëherë s'jam implikue. Personalisht kam pas unë me të muhabet, i kam thënë transmetoj të gjitha që ka qenë këtu, qiti në media, i kam thënë m'i qit, s'i kam thënë mos m'i qit. Kush i ka thënë mos me qit, e di ai. Edhe ai është duke më dëgjue. Të lutem, emra mos përmendni, se unë s'kam argumente, kush ka le të dalë këtu. Unë në vazhdimësi – qe ku është djali, vjen këtu e dëshmon – që unë kam lyp me u transmetue. Mos u bëni bre dyfytyrësja, me thënë jo kështu, e mandej ashtu. Edhe keq me e pas, kur e kie qeshtu, e kie mirë. E jo me e bo një herë kështu, hajt po e sulmojmë. Për çka e kanë prish kontratën? Për të mirën tonë, për të mirën e qytetarëve. A e dish që kërkush nuk ia ka ndalue atij me ardhë me e marrë kamerën edhe me e transmetue, qysh e ka transmetue edhe herave tjera. A pa pagesë a s'po bojka, a? A, qaty qenka problemi. Domethënë, dikush bën vepra – gazetarë e media, bëjnë pa pare për me njoftue opinionin. Edhe ky s'e ka bo punën, se s'i ka transmetue. Vetë keni thënë ju s'po i transmeton. Unë ju kam dëgjue juve qetu, unë s'e kam kqyr, ju vetë keni thënë qetu, edhe e dini kush ka thënë. Keni thënë s'po i bën qeto, e sot po delni po e mbroni. Bravo! Unë nuk e kam ditë bile që s'është ai prezent, unë ndjeva qetu, edhe më erdh mirë që s'kam ndie. Ju po e dijsht shumë mirë. Sot po e mbroni, e keni akuzue në mënyrën më të vrazhdë.

**Uran Halimi:** Meqenëse vendimi i kryetarit është i prerë, pra sot nuk do të vazhdoj transmetimi, edhe ne si Grup Parlamentar i LVV-së e kemi një vendim të prerë. Do ta lëshojmë këtë seancë, në shenjë proteste kundër ndalimit të transmetimit të kësaj seance. Ne si të deleguar të qytetarëve duhet atyre t'ua mundësojmë që të jenë të informuar, që të kenë sa më shumë transparencë. Nuk e

di unë pse s'po vjen, se ju s'po e thirrni. Përfundimisht, kemi vendos që ta lëshojmë këtë seancë!  
Faleminderit shumë!

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit! Transmetimi është drejtpërdrejt! Për transmetimin, edhe me pas qenë Radio Sharri, nuk ishte transmetue live. Sot e kemi buxhetin, më mirë është për buxhetin, në qoftë se je asambleist duhesh me ndejt për buxhetin. E jo për një media që kurr nuk e ka transmetue live. Përveç TV OPOJA, në bashkëpunim me Komunën, live është. Live është transmetimi, por sot është buxheti. Atëherë vendimi juaj është ndryshe, i kryetarit ndryshe. Unë kurrë nuk e kam thirrë Radio Sharrin, se nuk kam kontratë – edhe një herë po ju them – kontratë unë nuk kam pas kurrë me Radio Sharrin edhe unë nuk ia kam ndërprerë.

**Suada Bajrami:** Përhëndetje për të gjithë! E nderuar kryesuese, kryetar i Komunës, kolegë asambleistë, OSBE, media dhe të gjithë ju të pranishëm! Unë si kryetare e Grupit të Grave, në emër të Grupit të Grave Asambleiste, për nder të Ditës së Çlirimit të Dragashit e kemi organizuar një aktivitet madhështor, i cili ka pas për qëllim t'i bëjë bashkë gratë, për herë të parë në një aktivitet sportiv. Ka qenë aktiviteti i volejbollit në Bresanë dhe në Dragash. Pjesëmarrëse në këtë aktivitet ishin mbi 70 gra të punësuara nga QPS, QKMF, Komuna, mësuese, arsimtare, profesoresha, gratë nga sektori privat i firmave në Dragash. Dhe, ishte një aktivitet shumë i bukur, i cili u mbajt dy ditë. Radio Sharri, përveç që nuk e ka transmetue asnjëherë pjesë, as në Bresanë, as në Dragash, as mbylljen – që ka qenë një finale e madhe – unë kam pas telefonatë prej 70 grave, se unë e kam bërë thirrjen në bashkëpunim me gratë, sigurisht secila ndoshta keni pas edhe pyetje, pse nuk u transmetua? Krejt aktivitetet e Ditës së Çlirimit janë transmetuar ditën e nesërme ose të masnesërme, aktiviteti i Grupit të Grave nuk u transmetua. Në emër të krejt atyre pjesëmarrëseve – kanë qenë mbi 74 gra pjesëmarrëse – secila veç e veç, sa herë e kam takue, më ka pyet pse, a nuk ka qenë ky aktiviteti në emër të Komunës. Unë të njëjtën pyetje kam pas sot me ia bo edhe kryetarit. Vetëm aktiviteti i grave nuk ka dalë në media të Radio Sharrit. Krejt aktivitetet tjera janë bërë. Unë jam e frustruar me Radio Sharrin. Të njëjtën pyetje, pa e ditë që sot nuk është Radio Sharri, të njëjtën pyetje kam pas me ia bo edhe Radio Sharri, edhe kryetarit të Komunës – edhe pse kryetari i Komunës ka qenë pjesë e aktivitetit, me nënkryetarin gjithashtu – nuk e di pse bëhet ky diskriminim gjinor, pse ka qenë aktiviteti i grave. Nuk ka qenë një ditë, ka qenë dy ditë. Pas dy ditëve, Radio Sharri i ka publikue krejt aktivitetet e Ditës së Çlirimit, aktivitetin e grave jo. E njëjta pyetje është prej 74 grave veç e veç, pse Radio Sharri na ka diskriminue, aktivitetin e grave nuk e ka qit. Për këtë arsye, unë personalisht kam vendos me qëndrue në sallë edhe mos me lëshue sallën.

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit! Lëre që nuk ka ardhë në transmetim Radio Sharri që e ka mbajtur Grupi i Grave Asambleiste, një lojë të volejbollit që ka qenë jashtëzakonisht atraktive, edhe Tv Prizreni e ka qit – por lëre që nuk e ka qit as thirrjen si aktivitet, por e ka qit dy orë para Ditës së Çlirimit, gjë që dy ditë përpara ka qenë. Por prapë shkelje. Unë nuk kam kontratë me të, veç këto janë shkelje ndaj Kuvendit, ndaj meje si kryesuese.

**Munir Jonuzi:** Derisa të gjithë shefat e grupeve parlamentare po deklarohen nëse do të qëndrojnë apo do të largohen, unë duhet ta shpreh qëndrimin e Koalicionit Vakat – dhe ai është që ne do të qëndrojmë në këtë seancë, përkatësisht unë do të qëndroj në këtë seancë për disa arsye. Së pari, dua të shpreh shqetësimin për faktin se një medium, një transmetues, është ndaluar që të vijë këtu. Megjithatë, edhe ai transmetues disa herë në të kaluarën i ka fshirë fjalimet e mia. Më 28 shkurt, dy paraqitje të mia në Kuvend janë fshirë. I kemi ato – kur më është dhënë fjala nga kryesuesja, dëgjohet “ka fjalën Munir Jonuzi”, dhe më pas nuk ka asgjë – në vazhdim dëgjohet vetëm falënderimi i zonjës kryesuese. Kur e kam pyetur për çfarë bëhej fjalë, më është thënë se ka qenë problem teknik. Në të njëjtën seancë të Kuvendit, kur kam folur nga kjo foltore, ai ma ka prerë fjalimin që në hyrje. Dhe pastaj, ajo që kam folur nuk ka kuptim fare. Qëndrimi im është që Radio Sharri të kthehet – nëse jo sot, atëherë në seancën e ardhshme – sepse nuk është mirë t’i ndalohej askujt pjesëmarrja në këto seanca. Këto janë seanca publike dhe ka të drejtë t’i ndjekë çdokush. Mua personalisht më pëlqejnë transmetimet e Radio Sharrit, sepse na transmetojnë në origjinal, në dallim nga Televizioni Opoja. Kemi pasur situata kur një herë i ka mbaruar bateria, herën tjetër s’ka pasur internet – dhe fjalimi im nuk ekziston fare në arkivën e Kuvendit. Pra, qëndrimi im është që do të qëndroj në seancë dhe do të marr pjesë në diskutimin për draft-buxhetin për vitin 2026. Faleminderit.

**Agron Gashi:** Ju përshëndes të pranishëm assembleistë! Përshëndetje kryetar, znj.kryesuese! Unë desha të kyçem lidhur me mediumin Radio Sharrin, të cilën, siç e konfirmoi dhe kryetari, ekziston kontrata mes tyre, dhe si medium është dashur të jetë transparent me të gjitha zhvillimet që kanë ndodhur në këtë Asamble Komunale. Mospërmbajtja e rregullores, atëherë po thuhet se nga kryesuesja dhe kryetari ka pasur shumë vërejtje dhe qortime për moskryerje të detyrës së tij. Dhe, kryetari tha se është marrë një vendim, një pezullim, por pezullimi është dashur të jetë zyrtar me një shkresë, e cila është si dëshmi para kësaj Asambleje, që vërtet ju keni marrë masat e duhura ndaj tij. Po mundohem të jam i shkurtër, meqenëse vij nga fusha e arsimit dhe disa nxënës, në

shkollë, u mor vendimi për suspendimin e tyre dhe drejtori i suspendoi nga shkolla. Mirëpo, duke marrur anën ligjore nga ministria dhe DKA-ja, atëherë tha mosplotësimi i dosjes, ai duhet të kthehet. Nxënësit duhet t'i kthehen shkollës, për mosplotësim të dosjes. Dhe, unë po konsideroj se hapat, ecuria ka qenë në nivel të duhur dhe është suspenduar për një kohë të cilën ai nuk ia ka ndërprerë kontratën, të suspendohet dhe në seancën e radhës t'i kthehet kësaj Asambleje Komunale. Dhe, nëse është ligjrisht dhe zyrtare që ju e keni suspenduar apo e keni dëbuar sot nga kjo seancë, atëherë nuk plotëson shumë kriteret që ai të mos jetë prezent. Nëse ju posedoni sot një dokument të cilin e keni dhënë... edhe në Facebook mjafton. Vendimet shihen, edhe Facebook i ka vulat, i ka nënshkrimet, i ka të gjitha. Unë kështu jam i mendimit. Përndryshe, unë është dashtë që në këtë seancë të jetë prezent, në qoftë se nuk posedon diçka zyrtare. Faleminderit!

**Nexhat Selaj:** Përshëndetje edhe një herë! Arijeta, do të ju drejtohem pak juve, thaje që dy vjet, si jam unë këtu, nuk ka dhënë transmetim live. Për dy vjet unë e di që të kanë mbet edhe dy-tri seanca t'i udhëheqësh, ato bëjnë  $24-4=20$ . Po le të jenë 15 seanca. Për 15 seanca nuk keni qenë në gjendje që të merrni masa, por ta pritni kohën e fundit, kur të bëhet edhe buxheti dhe aspektet buxhetore, të shpaloser programi, edhe është fundi i këtij katërvjeçari, që të shihen të arriturat ku janë, ku janë dëshmitë, ku janë arsyetimet e asambleistëve për mospunë e mosvërejtje. Unë prapë po them, unë nuk e njoh kryetarin tash kaq kokëfortë, e njoh për transparent, edhe po besoj që kësaj radhe do ta lejojë me ardhë, që ta përcjellë për hir të qytetarëve dhe për hir të bashkatdhetarëve. Tash e kemi fluksin edhe të bashkatdhetarëve që do të na vijnë. Ata do të informohen edhe nëpërmjet Radio Sharrit, nëpërmjet radiove tjera, se çfarë i pret me një kornizë buxhetore 2026-2027 të cilën ne e kemi të gjithë para vetit. Në në vend që të diskutojmë tash, humbëm gjithë këtë kohë, u dashtë kryetar me kohë ta marrësh vendimin, ta lejosh që të marrish masë, për një muaj ditë ke kohë. E jo ta presësh këtë kohën e fundit, që na jemi në fund tash, ato zënkat e juaja le të mbesin te ju e te ekzekutivi me Radio Sharrin. Çfarë halli ka, çfarë derti, çfarë problemi ka qytetari që ai nuk i din këto. Ai pret nga ne, qytetari, se çfarë do të diskutojmë ne në të ardhmen edhe për këto 2-3 seancat e fundit, edhe për kornizën buxhetore 2026-2027. Unë po besoj që ju do të lëshoni pe, por për hir të qytetarëve do të lejoni që të është prezent Radio Sharrin, dhe masat të cilat ju mendoni t'i merrni, merrni deri në një seancë të radhës, por në seancë e radhës prapë ne të kemi dëgjimin e ndonjë medies. Po besoj që do të jam i arsyeshëm edhe do ta lëshë prezent me ardhë. Përndryshe, unë nuk mund të diskutoj pa më dëgjue qytetari. Unë votën e kam marrë nga qytetari.

**Arijeta Skeraj:** Qytetari është duke të dëgjuar. Radio Sharri nuk e ka transmetuar kurrë. Seriozisht po të them, Radio Sharri edhe sot me pas qenë nuk e kishte transmetue. Është duke dëgjue Radio Sharri. A nuk jeni duke kuptuar, apo s'po doni të kuptoni. Është duke ju dëgjuar qytetari. Krejt këtë seancën është duke e dëgjuar. Radio Sharri edhe buxhetin nuk e ka transmetue. E kreuva, veç mos thuaj me m'dëgjue qytetari, se qytetari është duke të dëgjuar. Për legjitime, edhe ai të gjitha seancat u dashtë live me i pas. Ky është legjitimiteti, kur e marrish një detyrë, me legjitimitet e bojsh seancën live. Sot ekzekutivi ka marrë vendim, jo unë. Jam ankue katër herë. Te Beqa. Beqa ka qenë te kryetari.

**Nexhat Selaj:** Nëse po më lejohet që të vazhdoj edhe pak. Po më vjen mirë që po më tregon që Radio Sharri nuk është, por është duke u përcjellë nga radiot tjera. Unë e kuptoj vetëm atë radio lokale me të cilën bëjmë kontratë edhe paguhet nga Kuvendi Komunal, paguhet nga paratë e taksapaguesve, Arijeta. Mediat tjera janë të mirëseardhura të gjitha, por unë dëshiroj që të është prezente ajo media e cila merr para nga taksapaguesit e Komunës sonë. Përkundër asaj, të thashë, 20 seanca nuk ke qenë në gjendje ju, me ekzekutivin, me e tërhek vërejtjen, e keni gjet kohën e fundit. Unë prapë po mbes nga një arsytim i imi – po ishalla jam i gabuar, nuk është ashtu çfarë po mendoj – mosprezenca e Radio Sharrit mos po ju konvenon juve, që mos të sheh qytetari hallet të cilat ne asambleistët i kemi këto 2-3 seancat e fundit. Për këtë arsye, po kam qef ta thirrni, që të jetë këtu edhe ta dëgjoj. Masi ka vazhdue 22 seanca, 20 seanca deri tash, mos me na dëgjue live, mas një dite a dy, le të dëgjoje edhe qeto dy a tri, sa i kanë mbet kohë, le ta vazhdojmë qeshtu. Ku e keni gjet në fund tash? Faleminderit!

**Driton Ademi:** Përshëndetje për të gjithë! Atëherë, unë pak po ndërlihem te parafolësi jem, kolega jem, që tha – kolegë – nuk mundesh, nuk merret parasysh në Facebook një vendim që e marrish, me një vulë të Komunës që është. Këtë harro! Nëse je mësue kështu qe katër vjet, mos u nis mo me shkue përpara. Kët po ta them. Po këtë e ke mësime prej kryetarit, se kryetari çka shkruan në Facebook mendon se është i marrot vendim. Nëse nuk e ka të qitot vulën e Komunës, nuk është vendim ai. E para, e dyta: Mu po më vjen mirë që janë nja dy media këtu. A janë vullnetare, a qysh i pagujnë, është mirë shumë. Edhe qeto dëgjimet e ekzekutivit që janë duke i parë sot, kjo është shumë mirë që është duke i parë këtë arrogancë të tyre ndaj Radio Sharrit. Pse ndaj Radio Sharrit? Nuk është që kam ndonjë interes ndaj Radio Sharrit, por jemi duke i paguar me taksat tona. Përderisa i pagujsh me taksat tona, ai person duhet me qenë këtu. Ajo radio duhet me qenë këtu. Mu po më vjen shumë çudi, pse ekzekutivi, me u bo pak më tolerant, me shkue në kohë të pazues

edhe e thirrë, edhe me e marrë. Po ku po e gjeni bash në KAB kur keni mbërri. A keni shumë keqpërdorime që ju s'po doni me i pa, i keni çue investimet veç ku ju kanë thënë njerëzit e juaj, a çka është problemi? Unë nuk po e di pse këtë amulli jeni duke e krijue qe dy orë, për një Radio Sharr, që tutnu me e thirrë. A s'keni numër telefoni, a t'jau sigurojmë? Për çka mos me e thirrë? Unë kam qenë i pari ai që e kam vërejt që Radio Sharri nuk ka qenë live. Edhe i ka thënë edhe kryesueses, është edhe në procesverbal. Vërejtja ime ka qenë e para për këtë punë. Po, kryesuesja e ka ngrit çështjen, por mas asaj ditës, kryesuese, më kurrë nuk e ke ngrit këtë çështje. Mos ndoshta, nashta edhe një herë a dy, po nuk e ke ngrit këtë çështje. Domethënë, qe dy herë kanë mund me qenë, hajt tri po ta lëmë, po për dy vjet, tri herë, a e dish sa seanca i ke. Domethënë, sot çonu, edhe ku e leni lënë ditën e mromë, ditën e 30-të e keni lënë KAB-në, më 30 qershor. Që e keni st të detyrueshme për me e çue në Prishtinë KAB-in. Mu po më vjen shumë keq që jeni t'u hup kohë qe dy orë – mendimi jem është, di Driton jam t'u folë, jo si grup parlamentar. Është koha e pauzës. Kryesuese, ne Kuvendi vendosim me vota, jo veç veton. Ti s'mundesh me marrë vendim pa e qit në votim. Unë po të them, nëse ke pak ndërgjegje si kryesuese, edhe si ekzekutiv, po shkojmë në pauzë, merrne pak më të arsyeshme, mas pauzës ftone edhe e vazhdojmë seancën. Faleminderit!

**Sefidin Mejzini:** Kryesuese, faleminderit për fjalën! I nderuar kryetar, të nderuar të pranishëm, media dhe ju të OSBE-së! Përshëndetje për të gjithë! Dëgjoni, kolegë, e kam një lutje për të gjithë! Është sot një buxhet shumë i rëndësishëm, shumë më i rëndësishëm sesa Radio Sharri. Personalisht s'kam kurgjo - e respektoj kur të takohemi privatisht – keni qenë ju që keni bo vërejtje vazhdimisht. Unë jam një mësues i thjeshtë që punoj me ciklin e ulët. Tash kemi nxënës, kur na prish qetësinë, ose e thyejnë një rregull, ne si mësues i marrim disa masa, ia japim një dënim, me qëllim për me e përmirësue, mos me na prish rendin në klasë. Kryetari është kryeplaku i shpisë, i Komunës. Edhe tash, prej ankesave tona ky e ka marrë një vendim për me e përmirësue. Është shumë e thjeshtë. Dëgjo, unë jam shumë i qetë. Shumë më i rëndësishëm është qeky që e kemi qetu përpara, sesa Radio Sharri. Vazhdimisht nuk na ka përcjellë. E përmendi edhe profa, e përmendi edhe Shpetimi. Me rëndësi është për popullin me punue, e jo me na dëgjue çka po folim na. Me i kqyr punët që po i bëjmë. Nuk është shumë me rëndësi për mu çka po foli këtu, me m'dëgjue ata. Është me rëndësi me i bo punët e mira. Edhe është mirë edhe ju me e tërhek fjalën, me e vazhdue seancën për hir të komplet trevës – Opojë e Gorë – që me ec përpara. Tash, nëse doni me bo politikë, kjo juve ju konvenon ma shumë, qekjo situata. Ju përfitoni ma shumë, po iu them edhe këtyre. Ju përfitoni, se tash është fundi. Finishi është shumë më interesant. Por, është e drejta e kryetarit - si

mësues i thjeshtë që jam unë, unë kam të drejtë – drejtori nuk mundet me m’u përzie te klasa ime. Po ju vazhdimisht jeni ankue. Po bën zhurmë një nxënës, ia kam dhënë një dënim, me qëllim për me e përmirësue. Shpetimi tha disa herë, edhe qeso herë lëshoni pe! Nuk është kurgjo, vetë keni pas ankesa vazhdimisht për Radio Sharrin. Qe unë po them, tërhiqnu ju, bre! Edhe këso herë, pse s’po tërhiqnu ju? Nuk e doni, bre, qaq shumë ju Radio Sharrin, seriozisht. Po qe dy vjet s’t’i ka transmetue live. Për hir të kësaj po reagoj, që po doni me e neglizhue. Opojë e Gorë është në pyejte, s’është Radio Sharri. Politikë nuk po dini me bo, seriozisht po ju them! Unë edhe një herë po ju kërkoj, ta vazhdojmë seancën. Qe, është Tv OPOJA, janë duke na dëgjue, mos t’jau teprojmë edhe atyre që na kanë votue. Faleminderit!

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit! Sqarimin e fundit po ia lëmë kryetarit, edhe, ose le ta thirrë, ose le ta vazhdojmë seancën. Unë nuk kam kontratë. Në qoftë se ky vendos që mos me e thirrë, nuk e thirr, se ky ka kontratë. Për një Radio Sharr u bo gjithaq problem. Në qoftë se kryetari lëshon pe, unë as nuk e kam thirrë kurrë, as nuk e kam qit kurrë, as nuk kam punë me të kurrë.

**Bexhet Xheladini:** Të nderuar delegatë, kam plotësisht të drejtë ligjore, brenda një minuti me ia ndërpre kontratën. Nëse ju jeni që një medium lokal me e dënue, edhe me ardhë një medium nga Prizreni e Prishtina – unë kam të drejtë ligjore, kam bazë ligjore në këtë minutë me ia ndërpre kontratën. Unë me Beqir Beqajn kam raporte jashtëzakonisht të mira personale. Ai e ka mbush kupën. Kryesuesja ka qenë disa herë, ma ka tërhek vërejtjen, merr masa. E kam thirrë atë disa herë në zyrë, më ka ardhë keq me ia ndërpre kontratën. Nuk ka nevojë as me i çue vërejtje atij, as kurgjo. Drejtpërdrejt në këtë moment – qe, e kam edhe zyrtarin ligjor këtu – kam të drejtë me ia ndërpre. Por unë nuk po dua. Unë po due me e disiplinue. Unë jam për mediat lokale me i stimulue. Edhe, po i përmendni shumë taksapaguesit. Na nuk kemi kontratë me Radio Sharrin që ai, punoi apo s’punoi, me e pague. Nëse vjen transmeton, paguhet. Nëse nuk transmeton, nuk paguhet. Për Ditën e Çlirimit, ka qenë ai prezent këtu, po masi nuk e ka bo transmetimin drejtpërdrejt, ajo faturë nuk i paguhet. Edhe sot Radio Sharri, për me u disiplinue, nuk ka me marrë pjesë, me i tregue atij që edhe Komuna e ka një rregull. Edhe ai nuk ka me marrë pjesë. Unë nuk tërhiqem prej kësaj. Radio Sharri, nëse do, e ka ligjin, e ka gjyqin, le të ankohet. Po ai e di që nuk ka të drejtë me u ankue, sepse e humb kontratën e përhershme. E di ai arsyen. Faji nuk është i kryesuese, kjo disa herë ka qenë te unë, e mu më ka ardhë keq me ia ndërpre. Po masi ju jeni krejt të pajtimit që unë kam bazë ligjore me ia ndërpre, ne mundemi edhe me ia ndërpre, si të kryhet seanca ia ndërpresë menjëherë. Kështu që, unë ju kisha lut, shumë më me rëndësi është qeky, sesa me qenë ose mos me qenë Radio

Sharri. I keni dy transmetime live, një në gjuhën boshnjake, një në gjuhën shqipe. Kështu që, opinionioni publik është i informuar krejt çka do të diskutoni. Lutja ime është ju të rriini në seancë. Edhe unë e kisha lut kryesuesen mo me e mbyllë këtë, se u debatua shumë gjatë. Definitiv është vendimi: Ai sot nuk mund të marrë pjesë në seancë!

**Arijeta Skeraj:** Atëherë, kryetari veç e ka marrë vendimin që Radio Sharri mos të jetë prezent. E kisha lut zyrtarin ligjor ta verifikojë a kemi kuorum, pasi që PDK dhe VV dolën jashtë. Atëherë, vazhdojmë! Kush është pro rendit të ditës? A ka kundër? Abstenim? Me 14 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë rendin e ditës. Vazhdojmë me pikën e parë: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro miratimit të procesverbalit? A ka kundër? Abstenim? Me 14 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe pikën e parë. Vazhdojmë me pikën e dytë: Miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028. Kush do me e marrë fjalën rreth kësaj pike?

**Munir Jonuzi:** Përpara nesh është propozimi i buxhetit për Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2026–2028. Në dokumentin që kemi marrë si material, në faqen e tretë thuhet se Komuna e Dragashit ka 35.000 banorë sipas regjistrimit të fundit. Nuk e di nëse bëhet fjalë për ndonjë gabim teknik, apo po e miratojmë këtë buxhet bazuar në regjistrimin e vitit 2011. Nuk e di nëse është fjala për regjistrimin e vitit 2011 apo të vitit 2024. A ka filluar të zbatohet regjistrimi i vitit 2024 për buxhetin e komunës? Duke pasur parasysh që në zgjedhjet e ardhshme lokale është zvogëluar numri i delegatëve në Kuvend, më intereson nëse buxheti i komunës ka mbetur i njëjtë. Nëse buxheti është i njëjtë, atëherë shihet një rritje nga 12.800.000 në 13.254.000 euro. Në atë konfigurim të buxhetit, dhe në bazë të dokumentacionit që na është dhënë, del se ndarja “fair share” është 61% me 39%. Nëse po bazohemi në regjistrimin e vjetër, atëherë ndarja “fair share” nuk është respektuar. Sa i përket investimeve kapitale, kam disa pyetje: Ndërtimi i deponive në Orqushë dhe Rrenc – çfarë lloji deponish janë këto? Për çfarë qëllimi do të ndërtohen? A janë për mbetje ndërtimore apo për mbeturina komunale? Te pika 3 kemi “ekspropriimi i pronave të AKP-së në Dragash dhe Brodosavc” – për çfarë lloj ekspropriimi bëhet fjalë këtu? Pika 4 – ndërtimi i kulmeve të ndërtesave në Dragash – a përfshihen të gjitha ndërtesat e vjetra në këtë projekt? Nëse po, atëherë 60 mijë euro do të jenë shumë pak. Bashkëfinancimi i projekteve me donatorë, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe MAPL – sa

kuptova nga Komiteti për Politikë dhe Financa, bëhet fjalë për një marrëveshje që kryetari e ka nënshkruar me KEDS-in, dhe se do të ndahen mjete për renovimin e rrjetit të tensionit të lartë në drejtim të Restelicës. Nëse është ky rasti, atëherë unë propozoj që në buxhetin përfundimtar të përfshihen Ministria e Zhvillimit Rajonal, MAPL dhe KEDS, sepse pjesa më e madhe e buxhetit do të shpenzohet për këtë projekt. Kjo për të mos krijuar paqartësi te qytetarët, që të dinë se komuna ka ndarë mjete për këtë vit dhe për vitin tjetër. Duhet të kemi kujdes të mos bie në kundërshtim me ligjet, sepse KEDS-i është ndërmarrje private dhe nuk bie nën Ministrinë e Zhvillimit Rajonal e as nën Ministrinë e Pushtetit Lokal. Na është tërhequr vëmendja disa herë që propozimi i buxhetit për Gorën nuk përputhet me materialin që kemi marrë. Kam kërkuar nga shefi i Zyrës edhe atë version tjetër të buxhetit – atë të saktin – mirëpo këtu mbetet për të ardhur keq pse këshilltari i lartë financiar nuk i qaset me më shumë seriozitet buxhetit, kur është fjala për komunitetet joshumicë. Pse nuk e trajton me më shumë përkushtim disa projekte? Këtu kemi emra vendbanimesh, sidomos në fshatrat gorane, të cilat fare nuk janë përfshirë në këto propozime për investime kapitale. Besoj se është rasti me çdo fshat, sepse e di se në Rapç ka gabim, prandaj besoj se situata është e ngjashme edhe në fshatrat tjera të Gorës. Nëse e krahasojmë me buxhetin e vjetër, në nenet 57 dhe 64, përkatësisht në propozimin që kemi marrë në material, është “ndërtimi i terrenit sportiv në fshatin Luboshtë” dy herë: njëra me shumë 30 mijë, tjetra 40 mijë euro – sipas mendimit tim, është krejtësisht jo serioze të marrim një material të tillë në Kuvend. Mirëpo, nëse e shikojmë propozimin aktual të buxhetit, atëherë ky projekt i terrenit sportiv është në shumë 40 mijë euro si projekt dyvjeçar – 20 mijë për vitin 2025 dhe 40 mijë për vitin 2026. Tani për pjesën “shërbime sociale dhe të rezistencës”, ndërtimi i shtëpive për persona me nevoja të veçanta në Komunën e Dragashit – për këtë nuk ka ndonjë shumë të caktuar, prandaj më intereson a është kjo sërish ndonjë gabim apo planifikohet diçka për këtë qëllim. Kemi një zë në buxhet pa vlerë të caktuar. Ju faleminderit.

**Sefidin Mejzini:** Përshëndetje edhe një herë për të gjithë! Pasi është Korniza Afatmesme e Buxhetit, nuk kam ndonjë vërejtje personale kështu, sa i përket listimit që është bo, për mu është krejt okej. Ka nevojë me u investue në çdo fshat, në çdo lagje, edhe detyra jonë edhe puna jonë është që këtë vend ta bëjmë më të jetueshëm për të gjithë banorët që jetojnë këtu. E kam një kërkesë – edhe nga banorët e fshatit Xërxe, por edhe kërkesë e banorëve të fshatit Kosavë – është një rrugë shumë e shkurtë, me një gjatësi 900 metër, është Kosavë-Xërxe dhe anasjelltas. Është çelë në

qeverisjen e kaluar dhe është rrugë që e lidh komplet trevën e Opojës me Komunën e Dragashit. Kësaj po e shoh që nuk i keni dhënë prioritet. Është mirë – s’po them që me e shti sot – por, bile në leximin e dytë me e bo një projekt dyvjeçar, se është gjatësia 900 metër. Është rrugë që e lidh komplet pjesën, shfrytëzohet. Tash na duhet me shkue deri në Pllajnik, të njëjtën rrugë duhet me e përshkue, kurse është 900 metër rrugë që është çelë. Është mirë, është hiç ma pak e rëndësishme sesa shumë rrugë që janë me asfalt këtu edhe janë kubëzue. Është diku 900 metër gjatësi, me një projekt dyvjeçar është mirë me e paraparë, ose me kubëzim, ose me asfaltim. Rrugët – duhet me e ditë të gjithë, jo pse po i kërkoj unë – rrugët janë të të gjithëve. Nuk më jetë syni pse është bo në Brodosanë ose është bo në Shajne, se na rrugët të gjithë i shfrytëzojmë, edhe duhet t’i shohim me këtë sy rrugët. Është i përshtatshëm, rruga e ka një bazë shumë të mirë me gurë, vetëm ka nevojë një përmirësim i lakut, edhe është rrugë që e përshkojnë të gjithë. Edhe postat tash që po punojnë online, vazhdimisht e frekuentojnë. Por, gjatë vërshimeve kjo rrugë ka dalë prej sistemit, makinat e vogla ecin, po ecin me vështirësi. Mirë është, kryetar, që me e pas parasysh me e shti. Është një gjatësi më pak së një kilometër. Kaq! Faleminderit!

**Edin Kurt:** Faleminderit, znj. Kryesuese. Së pari, desha t’ju tërheq vërejtjen: nuk quhem Edin Kurti, por Edin Kurt. Është mbiemër turk, që do të thotë “ujk”. Mirë, nuk është aq me rëndësi. Së dyti, desha të pyes – pasi që nuk jam anëtar i Komitetit për Komunitete dhe kolegët kanë folur sot – për këtë listën e projekteve për Gorë: a është kjo lista përfundimtare? A ka ndonjë ndryshim në të? Prandaj dua të di: a mund të flas tani për këtë listë që kemi marrë, apo ekziston ndonjë listë tjetër që duhet ta marrim? A mund të marr përgjigje? Apo të vazhdoj me këtë listë që e kemi marrë përmes emailit? Pra, a është kjo lista përfundimtare? Kështu, më intereson, z. Kryetar – kushdo që e ka hartuar këtë – pika 46: “Ndërtimi i infrastrukturës dhe kanalizimit në fshatin Brod”. Mua, z. Kryetar, ashtu si edhe qytetarëve me të cilët kam biseduar dhe bashkëfshatarëve të mi, nuk na është e qartë se ku do të bëhet ky ndërtim i infrastrukturës dhe kanalizimit. Prandaj dua të di – nëse mundeni – vendin dhe saktësisht se ku do të realizohet kjo. Pastaj, pika 52: “Ndërtimi i muzeut në fshatin Brod”. Kush do të jetë përgjegjës për këtë muze? Si planifikoni ta realizoni këtë projekt? A do të punësohet dikush në atë muze? Dhe gjëra të ngjashme – ju lutem të më sqaroni. Po ashtu, kam pyetur edhe vitin e kaluar, dhe do të pyes edhe këtë vit: pika 63 – “Ndërtimi i shtëpisë turistike në vendin e quajtur Rudinë, në fshatin Brod”. Më intereson si e planifikoni ta realizoni këtë? Kush do të jetë përgjegjës për këtë shtëpi? Nëse mund të shprehem

kështu – kush do t'i ruajë çelësat e kësaj shtëpie dhe kush do të jetë përgjegjës për të? E kam pyetur edhe vitin e kaluar dhe më thatë se do të miratojmë një rregullore, se do të ndërtohen edhe shtëpi të tjera të ngjashme në komunën tonë, dhe se do të përcaktohet me rregullore se kush do të jetë përgjegjës për to. Edhe këtë e kam të qartë. Por ajo që më shqetëson është që, nëse do të jenë përgjegjës kryetarët e fshatrave – le të themi, për shembull, kryetari i fshatit tonë është edhe anëtar i partisë SDU – atëherë kjo shtëpi do të bëhet, thuajse, zyrë e tyre. Prandaj ju lus për sqarim, që ta di se çfarë planifikojmë të bëjmë dhe si të votoj. Faleminderit.

**Suada Bajrami:** Përshëndetje edhe një herë për të gjithë! Kolegu parafolës ka të drejtë. Ne në mbledhjen e Komitetit për Komunitete, të premten, kryesuesi i Komitetit na ka premtue se ka me na pru një material të ndryshimeve që kanë ndodhë, ose saktë ku janë dedikue ato ndryshimet ose ato mjetet. Atë material sot u dashtë gjithqysh me qenë këtu. Ne po flasim për diçka që nuk kemi qysh me folë për atë. Unë, përveç që jam përfaqësuese e fshatit Shajne, unë jam përfaqësuese e popullit, përfaqësuese e Dragashit dhe të gjithë qytetarëve të cilët më drejtohen me ndonjë pyetje ose kërkesë, se për atë edhe vijmë këtu. Kërkesën tjerër – kryetar – banorët e Dragashit, te ura e sipërme, janë kryesisht banorë nga fshati Pllajnik, atje lartë krejt, udha te ajo pjesa ka fjet shumë. Është udhë e shtruar me kocka, por udha ka fjet dhe është shumë e dëmtuar. Ka shumë banorë ajo lagjja atje lart, edhe kërkesa e atyre banorëve është që të përmirësohet infrastruktura prej lart. Kërkesë tjetër kam prej banorëve të fshatit Shajne. Na në Shajne kemi probleme me ujin e pijshëm, si shumica e vendeve që e kanë këtë problem. Por, kjo situata e ujit e ka rëndue hala ma shumë gjendjen prej vërshimeve, prej reshjeve të vitit paraprak. Udha për me shkue në bjeshkë, u bo e pamundshme me kalue aty. Është një kërkesë jetike, është një kërkesë elementare. Banorët kohë pas kohe kanë shkue vullnetarisht i kanë pastrue ata gypat e ujnave. Momenatalisht është e pamundshme me shkue, duhet me shkue n'këmbë. E me shkue n'këmbë atje, dy orë rrugë është përpjetë. Ajo pjesa është 500 metër prej katundit lart. Kryetar, ne kërkojmë që të përmirësohet infrastruktura, rruga e bjeshkës, edhe të mundemi me ndërhy te uji. Faleminderit!

**Miralem Rahte:** Faleminderit. Ashtu siç thanë edhe të tjerët para meje, siç e tha edhe Suada më herët, në Komitet ne kemi marrë një vendim që të na dërgohet të gjithë neve delegatëve materiali i duhur, pasi është konstatuar se ka shumë gabime në këtë draft të buxhetit. Mendoj se administrata nuk e ka marrë parasysh kërkesën tonë, si vërejtje nga Komiteti për Komunitete. Shpresoj që kjo të rregullohet në buxhetin përfundimtar. Së dyti, pasi që z. Edin Kurt përmendi

çelësat për shtëpizën, kryetari i fshatit është Shefket Ismaili, anëtar i partisë SDU, por gjithashtu edhe ne të dy jemi në këshillin e fshatit – Edin Kurt dhe unë personalisht, Mirale Rahte, dhe Shefket Ismaili. Ne përbëjmë atë këshill, dhe nëse i merr çelësat Shefketi, do t'i marrësh edhe ti. Faleminderit.

**Bexhet Xheladini:** Të nderuar delegatë! Unë po ju përgjigjem me rend propozimeve të delegatëve. I pari që diskutoi ishte z.Munir Jonuzi. Duhet t'i them se aty është gabim. Buxheti është ndarë për Komunën e Dragashit dhe për të gjitha komunat e Kosovës, në bazë të regjistrimit të fundit. Aty është një gabim, si çdo herë, barten shënimet e vitit të kaluar në këtë vit, edhe ZKF-ja nuk e ka përmirësuar. Buxheti është i ndarë në bazë të regjistrimit të fundit të Popullsisë, të vitit 2025. Deponitë Rrenc edhe Orqushë, me Planin Zhvillimor Komunal që është alfa dhe omega, apo kushtetuta e Komunës, në ato dy vende është e paraparë që këto deponitë e mbetjeve të ngurta të ndërtohen. Këto nuk do të bëhen deponi të amvisërisë, jo të mbetjeve organike të cilat mund të kundërmojnë edhe mund ta ndotin ambientin, por do të bëhen deponi me mbetje të ngurta. Janë ndarë mjete, ne planifikojmë që bashkë me donatorë edhe investitorë t'i ndërtojmë këto dy deponi. Këto vendime i ka marrë Asambleja Komunale vitin e kaluar. Në këto vende ku do të bëhen deponi – ku planifikohen të bëhen – këto vende kanë qenë të Pylltarisë, Asambleja Komunale dhe unë si kryetar i jemi drejtuar Qeverisë së Kosovës – që e falënderoj - na i ka dhënë ato dy vende pa kompenzim. Kështu që, ato ne mund t'i shfrytëzojmë për ndërtimin e deponive. Sa i përket ekspropriimit, këto janë prona ku Asambleja Komunale ka votue që pronat e AKP-së, të cilat ata kanë dashtë me i shit, por ne e kemi pru një vendim që AKP-ja këto mos t'i shesë, për arsye se Komuna ka nevojë për këto prona, që t'i mbajnë në pronësi të tyre. Janë disa prona që i kemi përmend, këtu janë vendimet dhe nuk due me ju lodhë më shumë. Sa u përket kulmeve të banesave, këto do të jenë projekt dyvjeçar, në vitin e parë i kemi ndarë 60 mijë euro, në vitin e dytë do të ndajmë mjete të mjaftueshme sa do të kërkojë tenderi. Nëse për vitin e dytë kërkonë 100 mijë , atëherë do t'i ndajmë edhe 100 mijë. Planifikojmë të gjitha këtyre ndërtesave për të cilat qytetarët kanë pas shumë ankesa, t'ua rregullojmë kulmin. Sa i përket subvencionimit të pozicionit “Subvencionim me donatorë”, kur ta përgatitim tash për me e çue në Prishtinë këtë vendimin edhe listën e projekteve, do ta shënojmë edhe sa mjete janë të parapara për me e subvencionue projektin për ndërtimin e tensionit të lartë në drejtimin Restelicë dhe Brod. Këto vërejtje që i ka dhënë Munir Jonuzi, në listën e cila do të përgatitet për me e çue në Ministrinë e Financave do të përmirësohen.

Edhe sa i përket Libevishtit që e përmendi. Edhe sa i përket ndërtimit të shtëpive për persona me nevoja të veçanta, është formular i Ministrisë ky, ku disa komunave qeveria u ka ndarë mjete, ndërsa neve nuk na ka ndarë. Me sa e di unë, vitin e ardhshëm ose në vitin 2028 ne vijmë në rend dhe atëherë qeveria do të na ndajë mjete për ndërtimin e këtyre shtëpive. Në vitin 2026 qeveria nuk na ka ndarë mjete me i ndërtue këto shtëpi. Sefidin Mejzini e përmendi rrugën e cila lidh dy rrugët e asfaltuara që shkojnë në drejtim të fshatit Pllajnik. Është një rrugë të cilën unë e kam kalue dhe është një propozim shumë i arsyeshëm, dhe unë do të mundohem që këtë rrugë ta futim në Grantin e Performancës që do ta ftojme këtë vit. Edin Kurt pyeti për kanalizimin. Është përmend vetëm si pozicion, por vitin e ardhshëm, kur të bëhet projekti, kryesia e fshatit, aty ku ka nevojë ka me e dhënë propozimin dhe ka me u bo projekti për renovimin e kanalizimit. Muzeu në Brod është kërkesë e qytetarëve të fshatit Brod, kërkesë e personit i cili e ka një muze shumë të mirë dhe ka shumë gjëra të rëndësishme aty, por ai ambient është shumë i ngushtë, për ato mjete të cilat janë aty nuk po mjafton hapësira. Kështu që, është mirë që propozuesit e këtij buxheti nga komuniteti joshumicë kanë paraprë mjete, që nuk janë edhe aq të mjaftueshme, mirëpo në bashkëpunim me donatorë – sigurisht që do të kemi donatorë – do ta realizojmë këtë projekt. Nuk e di a e keni gjet lokacionin a jo, po megjithatë është një propozim që edhe unë si kryetar e kam përkrah. Sa i përket shtëpisë malore, e more përgjigjen edhe nga kolegu yt, Miralem Rahte. Suada Bajrami, bashkë me kryesinë e fshatit, kanë qenë një ditë te unë në zyrë, dhe ne jemi marrë vesh që, buxheti që është paraparë për vitin e ardhshëm në Shajne, të ndahet tri projekte: një pjesë e mjeteve të shkojë për rregullimin e rrugës e cila e lidh Shajnen me bjeshkën, ku në këtë projekt do të futet edhe rehabilitimi i ujëmbledhësve. Gjithashtu, do të ndahet një sasi e mjaftueshme e mjeteve për ndërtimin e një parkut afër shkollës, te pishat, dhe një këndi të lojërave për fëmijë në shkollë. Gjithashtu, ajo e përmendi edhe një rrugë e cila është në drejtim të Radeshës, por që është në qytezën e Dragashit, e cila është prish. Ne kemi pozicion të mjeteve, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale, dhe në atë pozicion ne mund t'i parashohim dhe ta rregullojmë këtë rrugë. E përmendi a do të punësohet dikush. Nuk e di, ne, pasi të ndërtohet ky muze do t'i drejtohem Ministrisë së Kulturës që të na lejojë një kod për punësimin e një personi i cili do të punojë në muze.

**Edin Kurt:** Së pari dua t'i përgjigjem kolegut tim, Miralem. Unë nuk po kërkoj që ta posedoj apo ta kem çelësin, thjesht po kërkoj që ai çelës, kur të ndërtohet objekti, të mos keqpërdoret dhe

të mos u jepet vetëm atyre që ata dëshirojnë. Por për këtë do të flasim përsëri kur të ndërtohet. Së dyti, zoti kryetar, desha t'ju përgëzoj – pak më herët harrova – për ndërtimin e rrugës Kukajlanë- Dragash, e cila është me të vërtetë një projekt me rëndësi. Rruga është në gjendje shumë të keqe. Kjo nuk është vetëm rruga Kukajlanë-Dragash, ajo rrugë është e një rëndësie të madhe edhe për fshatrat e tjera, si dhe për zhvillimin e turizmit në komunën tonë dhe në Gorë. Së treti, zoti kryetar, desha t'ju tërheq vërejtjen që në shtator, kur të votohet zyrtarisht buxheti, të shkruani emrat e rrugëve, se ku do të shpenzohen ato mjete, në mënyrë që ta dimë kur të flasim me qytetarët dhe banorët e fshatrave – të dimë çka do të bëjmë, si dhe ku do të punojmë.

**Samidin Xheladini:** Unë e kam një propozim – ndoshta edhe nuk realizohet, por le të jetë si opSION. Është bërë rruga Kapre-Rrenc. Rrenc – Shajne, kqyrne mundësinë me e bo edhe një shkurtim. Do të ishte fenomenale. Në të ardhmen, edhe një mandat si ta marrish këtë kryje, do të ishte shumë e mirë. Faleminderit!

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro miratimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028, me këto ndryshime dhe propozime që i kanë lyp asambleistët? A ka kundër? Abstenim? Me 14 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e tretë: Miratimi i Listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Dragashit. A do dikush me e marrë fjalën?

**Anesa Mehmeti:** Përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryetar, e nderuar kryesuese, të nderuar asambleistë! Kam një kërkesë prej banorëve të fshatit Zgatar, që rruga e cila aktualisht figuron si “Kodra e Llollës”, një pjesë e asaj rruge të rikthehet me emrin “Lagjja Berisha”. Jo komplet rruga, vetëm një pjesë e rrugës, andej nga fshati Brrut. Berisha, ashtu siç është njohur paraprakisht prej banorëve të fshatit Zgatar. Vetëm një pjesë e rrugës, jo komplet rruga. Nëse ka mundësi! Ju faleminderit!

**Bexhet Xheladini:** Ky emër që e përmendet ju, duhet të futet një herë si emër në listën rezervë. Pastaj, kryesia e fshatit e bjer një kërkesë zyrtare, edhe duhet me e caktue saktë nga ku deri ku don me ndërrue këtë emër. Pasi që thatë se vetëm një pjesë të rrugës. Kështu që, një herë së pari është me rëndësi në listën rezervë me u fut qeqy emër, me emrin e saktë cili ishte – apo Ademi ndoshta e di, le ta shënojë saktë.

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 13 vota për, 1 kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Atëherë, vazhdojmë te pika e katërt, pika eventuale. Kush do me e marrë fjalën?

**Agron Gashi:** Atëherë, unë vetëm dy pyetje kam dalur t'i bëj këtu. E kemi fjalën për Ujësjellësin – edhe drejtori i Financave ndoshta mundet të na japë një sqarim – deri ku kemi arritur dhe këtë vit a do të lëshohet uji për 15 fshatra që është planifikuar, sepse qytetarët janë në pritje. Mungesa është duke u nider Gorë e Opojë. A do të lëshohet, përafërsisht kur do të lëshohet, dhe pyetja e dytë që ju drejtohem – edhe e kërkuar nga banorët e fshatit – ku kemi arritur me kanalizimin e fshatit Brezne? A do të lëshohet një pjesë këtë vit, pas ndreqjes dhe rregullimit të impiantit, meqenëse është duke u punuar. Apo komplet a pjesërisht, a do të lëshohet në qarkullim. Këto janë dy pyetje të cilat jua drejtoj. Faleminderit!

**Qamil Kolloni:** Përshëndetje kryetar, përshëndetje ju të pranishëm të gjithë këtu! Përshëndetje, delegatë! Sa i përket pyetjes së delegatit Agron Gashi, për ujin për 15 fshatra, mbi 90% e punimeve janë në përfundim e sipër. Ujësjellësi ka marrë formën e përfundimit të projektit. Realisht, jemi në fazën e lejes energjetike nga KEDS-i për funksionalizimin e energjisë elektrike, ku duhet ekspertët nga Sllovenia të vijnë edhe të bëjnë montimin e pajisjeve dhe trajnimin e stafit për lëshimin e fabrikës në përdorim. Sa i përket rrjetit shpërndarës për të gjitha fshatrat, rrjeti është krye në përgjithësi. Gjithashtu, deri te pika e parë të fundërrimit – nuk kam ndonjë monitor – por shumë shpejt do ta shihni përmes televizionit, kur do të dalë kryetari dhe ta bëjë një vizitë, sepse që nga diga ku është ndarë uji dhe deri te fundërrimi, faza e parë, veç uji qarkullon. Pritet që të instalohen mjetet nga ekspertët sllovenë në fabrikën e ujit, e cila e bën filtrimin e ujit dhe trajtimin e tij. Sa i përket rrjetit në anën e Opojës, përfundimisht, të gjitha fshatrat e kanë të kryer. Është një pjesë e vogël në fshatin Kërstec që, gradualisht, duke i kryer këto punimet, do të kryhet edhe ajo pjesë. Ne mendojmë se shumë shpejt do të jemi dëshmitar, kur do ta shihni ujin që do të funksionojë. Prandaj, na kanë dalë punime shtesë, për shkak se bazenat të cilët janë ndërtuar në vitet 2012 – 2014 – 2016, kanë çarje të mëdha. Edhe një herë janë detyruar kompanitë që të hyjnë edhe të intervenojnë te ato bazene, dhe sa do të mund të ia zgjatin ymrin, nuk e di. Por, për momentin ato do të jenë funksionale, sa për me e dëshmuar se uji do të fillojë dhe do të punojë mirë. Mirëpo, në qoftë se te këto rezervuarë paraqiten defekte të mëdha, duhet të mendojmë në të ardhmen që edhe këto defekte t'i eliminojmë dhe përfundimisht ky ujë të funksionojë. Është bërë edhe matja e

ndarjes së ujit. Shumë pak dëmtohet lumi në aspektin e marrjes, që merret prej atij uji, që bëhet ndarja për ujë të pijshëm. Faktikisht, tash e kemi edhe me fotografi, edhe me dokumentacion, edhe me matje, se lumi nuk dëmtohet fare. Është një sasi tepër e vogël. Por, atë do ta bëjmë me slide-a dhe do ta qesim këtu, që ta shohin të gjithë delegatët, edhe të hiqenë të gjitha ato dilemat se janë bërë me qëllim, janë bërë dëme, ka pas defekte – të gjitha në mënyrë analitike do të marrim edhe t'i sqarojmë. Edhe, me fakte do ta dëshmojmë se ky ujë do t'i sjell profit Komunës, për faktin se të gjitha këto fshatra të cilat duhet të kyçen, duhet të jenë parapagues. Në momentin kur do të parapaguajmë dhe t'i shtijmë në pagesë të ujit, ne do të përfitojmë edhe grantin për rregullimin e projektit të vetëm më gjigant, që është për trajtimin e ujërave të zeza, nga Bashkimi Evropian. Prandaj, unë mendoj se jemi në fazën më të mirë të mundshme, dhe e uroj edhe një herë kryetarin edhe qeverinë, por edhe operatorët ekonomikë të cilët nuk na kanë korit në këtë rast, sepse kanë dalë aq punime shtesë, që nuk e keni idenë as vetë. Mirëpo, kanë punuar me korrektësi të tre operatorët dhe jemi në fazën përfundimtare të këtij projekti gjigant. Sa i përket kanalizimit të fshatit Brezne, do të bëhet përpjekje që Impianti për trajtimin e ujërave të zeza në fshatin Brezne të përfundojë sa më parë. Kapaciteti i këtij impianti që po ndërtohet në fshatin Brezne është për 30 mijë banorë. E keni fatin që me teknologjinë më të re jeni duke e ndërtuar një impiant të tillë, dhe besoj që do të funksionojë shumë mirë për Breznen, por do të duhet të kemi prurje më të mëdha, për me qenë sa më jetëgjatë. Do të vjen eksperti i cili është duke e mbikëqyrë këtë projekt, do të bëjë sqarimin edhe para banorëve të fshatit Brezne, sepse kjo është një teknologji e re që për herë të parë po hyn në përdorim. Besoj se do të jemi të kënaqur të gjithë bashkërisht. Ky nuk mund të bëhet pjesërisht, ky duhet të kryhet në mënyrë gjenerale, në përgjithësi, për me qenë funksional. Ne besojmë se, operatori i cili e ka marrë, na ka premtue, në qoftë se nuk i dalin probleme eventuale, me e krye këtë vit. Faleminderit!

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit! Atëherë, në qoftë se nuk ka të tjerë që dëshirojnë ta marrin fjalën, e mbyllim këtë seancë! Ju faleminderit dhe shihemi në seancat e radhës!